



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2022:174455

Datë: 24.09.2024

Numri i dokumentit: 06201194

Pml.nr.559/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar i kolegjit, Agim Maliqi dhe Mejreme Memaj, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale të të dënuarit T. B., për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1, nënpar.1.4 të Kodit penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të të dëmtuarit I. Gj. të paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.260/2022 të datës 06.02.2024 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.773/2024 datë 05.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 24 shtator 2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet si e papranueshme kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dëmtuarit I. Gj., paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Dega në Istog - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.260/2022 të datës 06.02.2024 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.773/2024 datë 05.06.2024.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Pejë - Dega Istog - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.260/2022 e datës 06.02.2024, të dënuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1, nënpar.1.4 të KPRK-së dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 7 (shtatë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën kohore prej 2 (dy) vite nga data e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 20 €, në emër të paushallit

gjqësor dhe shumë prej 20 €, në fondin për kompensimin e viktimave të krimit, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.773/2024 e datës 05.06.2024, ka refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtësit të të dënuarit dhe palës së dëmtuar dhe aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka ushtruar i dëmtuari I. Gj., pa përcaktuar bazën ligjore dhe as propozim konkret.

Prokurori i Shtetit të Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.325/2024 e datës 10.09.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e të dëmtuarit I. Gj. të hudhet si e papranueshme.

Gjykata Supreme e Kosovës, në kuptim të nenit 435 par.1 dhe par.2 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), i shqyrtoi shkresat e lëndës dhe gjeti se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e papranueshme.

Konform nenit 433 par.1 të KPP-së, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqes Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në emër të tij mund të paraqesin personat e paraparë në nenin 424 par.1 i këtij kodi.

Andaj, nga kjo dispozitë ligjore del se i dëmtuari nuk është në mesin e këtyre personave me të drejtë të paraqitjes së kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë, andaj edhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë ishte e papranueshme.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 435 par.2 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**  
Pml.nr.559/2024, më 24 shtator 2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Afrim Shala